



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:046018

Datë: 26.02.2024

Numri i dokumentit: 05372897

C.nr.227/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Izet Gërguri, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.D nga Komuna Vushtrrisë dhe A.U nga Vushtrria të cilat i përfaqëson av.A.B nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, lidhur me kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, jashtë seance, me datën 26.02.2024, mori dhe e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.D dhe A.Xh nga Vushtrria, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë,

- a) Paditëses A.D, për periudhën kohore nga data 01.10.2020 e gjerë me datën 08.02.2021 apo për 49 ditë të pranisë në punë, t'ia paguaj shumën prej 98 euro, ndërsa
- b) Paditëses A.Xh për periudhën kohore nga data 01.10.2021 e gjerë me datë 08.02.2021 apo për 64 ditë të pranisë në punë, t'ia paguaj shumën prej 138 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë me datën 11.03.2021 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 137 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditëset A.D dhe A.Xh nga Vushtrria, të cilën sipas autorizimit i përfaqëson av.A.B me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate kane paraqitur padi me datë 11.03.2021, me të cilën kane kërkuar që të obligohet e paditura që për periudhën si ne diapozitiv te këtij aktgjykimi, t'ia kompensoj shpenzimet e ushqimit dhe atë shumën prej 2 euro për gjdo dite te pranisë ne punë, apo shume e përgjithshme si ne diapozitiv te këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes se padisë e gjer ne pagesën definitive si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilim te padisë shumen pre 104 euro si dhe për takse gjyqësore sipas tarifës se OAK.

Gjykata me aktvendimin C.nr.227/2021 të datës 13.10.2023, ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në padi, të cilin aktvendim e ka pranuar me datë 16.11.2023, ndërsa përgjigjen në padi e ka paraqitur me datë 01.12.2023.

Në përgjigjen në padi e paditura ndër të tjera ka deklaruar se padia dhe kërkesëpadia e paditësve është parashkruar pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar më 18.04.2017 ndërsa paditësja e ka paraqitur padinë në gjykatë me datë 11.03.2021, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit është me efekt veprimi deri më 18.04.2020 dhe se e njëjta nuk ka efekt për asnjë kërkesë

e cila lind pas kësaj date. Gjithashtu gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëses ta hedhë poshtë si të palejuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palës nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit merititor.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqës të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditëset kanë themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe me kontratat e punës, e datës 08.10.2020 për A.D kontestuese nuk ishte prania në punë për 49 ditë dhe kontrata e punës për A.Xh e datës 08.10.2020 kontestuese nuk ishte prania e paditëseve në punë për 64 ditë, kontestuese nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë.

Kontestuese ishte parashkrimi i kërkesës së paditëseve mirëpo edhe ky pretendim i të paditues është i pa bazuar pasi që paditëses kërkesat e tyre i kanë paraqitë brenda afatit ligjor me Ligjin e Punës.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se *“kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 si dhe asaj të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë idetntike është paraparë se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”*, dhe vërtetimit të lëshuar me datë 08.02.2021, nga Drejtoria e Arsimit Institucioni parashkollorë “F...”, në Vushtrri, për paditësen A.D për periudhën nga data 01.10.2020 e deri më 08.02.2021, erdhi në përfundim se kërkesa e paditëses është e bazuar, andaj edhe ia njohu shumën prej 98 euro, duke përlllogaritur një ditë pune me 2,00 euro (49 ditë pune x 2 euro = 98 euro), si dhe vërtetimit të lëshuar më datë 08.02.2021, nga Drejtoria e Arsimit Institucioni parashkollorë “F...” në Vushtrri, për paditësen A.Xh për periudhën nga data 01.10.2020 e deri më datën 08.02.2021, erdhi në përfundim se kërkesa e paditëses është e bazuar, andaj edhe ja njohu shumën prej 128 euro, duke përlllogaritur një ditë pune me 2.00 euro (64 ditë pune x 2 euro = 128 euro)

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses, gjykata e vlerësoj si të pa bazuar pasi që në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ndërsa paditëset kërkesën e tyre e kanë parashtruar për periudhën nga data 01.10.2020 deri më 08.02.2021, dhe për periudhën nga data 01.10.2021 deri me date 08.02.2021 që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2021, ndërsa padinë e ka paraqitur në gjykatë më 11.03.2021. Gjithashtu me Kontratën Kolektive të Arsimit të vitit 2017 në nenin 45 të saj është paraparë se Kontrata Kolektive do të

zbatohet edhe për një vit tjetër nëse palët nuk terhiqen nga e njëjta ndërsa gjykata nuk ka prova se nga e njëjta janë terheqë ndonjë palë kontraktuese.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, paditësve ua njohu edhe të drejtën në kamatë në lartës prej 8%, duke llogaritur nga data 11 .03.2021, nga dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive në pajtim me nenin 378 të LPK-së e në pajtim me mendimin juridike të Gjykses Supreme të Kosovës të datës 01.12.2020.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për shpenzimet e procedurës, bazuar në nenin 452 të LPK-së, dhe atë përpilim padie 117 euro (për dy paditëse dhe kontest i vleres së vogël) si dhe për taksë për padi në lartësi 21 euro.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil
C.nr.227/2021, datë: 26.02.2024

Gj y q t a r i
Izet Gërguri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit, në kopje të mjaftueshme

Numri i lëndës: 2021:046018
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05372897